

10539

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR 10539/2 VENDIMIT

V E N D I M
I GJYQPARIT TE VETEM

Sot me dt. 10.02.98, une gjyqtari M. Deda prane Gjykatës Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e bere nga :

- KERKUESIT :Nexhat Sheqi, i biri i Brahimit, banues ne Shkoder lgj. S. Halili Rr. Oso Kuka Nr. 99
2. Vebi kraja, i biri i Shuajpit, i dl. 1954, banues ne lgj. D. Matlia Rr. Koplikej Shkoder .

ME OBJEKT : Depozitimin e vendimit date 2 shkurt 1998 te Asamblese se ortakeve lidhur me shtesen e aktivitetit te SHPK Drini. Ligja 7667 dt. 28.1.1993

K O N S T A T O V A S E :

Me vendimin nr. 10539 dt.27.4.1995 te Gjykatës Rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik SHPK Drini, me ortake dy kerkuesit dhe me objekt te kesaj shoqerije: Prodhim materiale inerte,prodhim materiale ndertimi, imp.exp. i artikujve industrial ushqimor, materiale ndertimi, karburante dhe lubrifikante, vajguri, makineri e pajsje, plehra kimike, produkte bujqesore e blektorale, pajsje elektro-shtepiake me shumice dhe pakice. Me vendimin date 2 shkurt 1998 asambleja e ortakeve ka vendosur zgjerimin e objektit te veprimtarise se shoqerise dhe konkretisht l. Ndertim te objekteve te ndryshme ndertimi si objekte kulturi, social kulturore, ushtarake, turistike, shtepi banimi etj. 2. Ndertim e riparim urash, rrugesh, sisteme ujitjeje dhe bonifikuese.

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjes 7667 dt. 28.1.1993

V E N D O S A :

Depozitimin ne rregjistrin tregtar te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar DRINI SHPK.NR. 1 Urdhnerimin e Zyres se rregjistrit tregtar te bejne ndryshime -met perkatese.

Tirane me 10.02-1998

G J Y Q T A R I
M. Deda

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 10539/4 Vendimit

6318

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 17. 3. 1999 une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane Orjesta Piku mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Vehbi Kraja per depozitimin prane rregjistrit tregetar te Gjykates se rrethit Tirane te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise tregegare " DRINI " shpk dhe

K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr. 10("i date 27/4/1995 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare " DRINI " shpk me ortakut z; Nexhat Sheqi dhe Vehbi Kraja ne administrator z; Shuajip Rrjelli.

Me vendimin nr. 10539 /1 date 10/2/1998 te kesaj gjykate eshte vendosur nje shtese ne objektin e veprimtaris se shoqerise.

Me vendimin nr. 10539/2 date 17/3/1999 te kesaj gjykate eshte vendosur largimi nga kjo shoqeri e ortakut Nexhat Sheqi dhe ngelet ortakut i vetem ne shoqeri Vehbi Kraja dhe administrator Shuajip Rrjelli.

Me vendim te ortakut te vetem te kesaj shoqerie eshte vendosur nderimi e emertimit te shoqerise nga " DRINI " shpk ne " DRINI - A " shpk dhe shkarkimi i administratorit e z; Shuajip Rrjelli dhe emerimi i administratorit e z; Vehbi Kraja;

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 date 28/1/1993 dhe te ligjit 7638 date 19/11/1992

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane rregjistrit tregetar te Gjykatese rrethit Tirane te vendimit te ortakut te vetem te shoqeris tregetare " DRINI " shpk e dates 17/3/1999. *M!*

Urdhoret zyra e rregjistrit tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kollenen 4.5.2a3 germa _____ si dhe ndarja me vize te kuae nga njeri tjetri;

GJYQTARE

Orjesta Piku

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 10539/3
6311

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me dt. 17.3 . 1999 ,une gjyqtare Nexhat Sheqi ne Gjykatën e rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuësve Nexhat Sheqi dhe Vehbi Kraja me ane te ciles kerkon depozitimin prane Gjykates se rrethit Tirane te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI"sh.p.k. me nr. 2 dt.23.02.1999 dhe

K O N S T A T O V A

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DRINI"sh.p.k. eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr. 10539 dt 27.04.1995 dhe nr. 10539/2 dt. 10.02.1998 dhe ka si ortak z.Nexhat Sheqi dhe Vehbi Kraja.

Me vendimin nr. 2 dt.23.02.1999 asambleja e Ortakeve te shoqerise ka vendosur per te hequr si ortak te shoqerise z.Nexhat Sheqi Duke u bere keshtu si **ortak i vetem i kesaj shoqerie** **z.Vehbi Kraja** i cili ne baze te kontrates se shit-blerjes se kuotave i ka blere kuotat e z.Nexhat Sheqi ne masen 50% te kuotave te shoqerise ,duke u bere keshtu pronare ekskluziv e administrator mbi krejt kapitalin themeltare te kesaj shoqerie ne vleren 600.000 leke,te cilet kerkojne depozitimin e vendimit te sipertreguar ne Gjykatën e rrethit Tirane .

Kerkesa eshte e drejte e si e tille duket pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Ne baze te ligjit nr.7667 dt.28.01.1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtare".

V E N D O S A

Depozitimin e vendimit nr. 2 dt. 23.02.1999 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " DRINI "sh.p.k. ne Gjykatën e rrethit Tirane duke bere shenimet perkatese ne rregjistrin tregtare duke hequr vije te kuqe ne kolonen nr.4 me numer rendor 2.

G J Y Q T A R E

Nexhat Sheqi


A K T I T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DRINI" SH.P.K.

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA

Duke u bazuar ne ligjin 7512 dt. 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, dhe veprimtarive private te pamvarura dhe privatizimin" ligjes 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjes 7667 dt. 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtare" ortaket:

z. Nexhat Sheqi i biri i Brahimit i dt. 1958 banues ne lagj. S. Halili, Rr. Oso Kuka, Nr. 99 Shkoder.

z. Vebi Kraja i biri i Shuajpit i dt. 1954 banues ne lagj. D. Matlija, Rr. Koplakaj:

Kane krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emerin "DRINI" sh.p.k.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. eshte:

Prodhimi i materialeve inerte, prodhimi i materialeve te ndertimit, imp-exp. i artikujve industrial, ushqimore, materiale ndertimi, karburante e lubrifikante, vaj-guri, makineri e paisje, plehra kimike, produkte bujqesore e blegtorale, paisje elektroshtepiake me shumice dhe pakice.

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. eshte ne lagj. Bahcallek Shkoder.

KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. eshte mbi 11 vjet.

KAPITALI THEMELTARE

Kapitali themeltare i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. eshte 600.000 lek. Pjese e pandare e ortakeve te cilet kane te drejte en ekskluzive te administrimit te ketij kapitali.

Organi me i larte ne shoqeri eshte asambleja e ortakeve qe ne rastin

e kesaj shoqerije perfaqesohet nga ortaket Nexhat Sheqi dhe Vebi Kraja.

Administrator i shoqerise eshte Shuaqip Rrjolli.

~~Presidenti i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k.~~

~~Kontratat e shpirtorve te cilat te marra nga kompania e kufizuar dhe aktet themelore, jane te detyrueshme per shoqerine.~~

Ne raste mosmarrveshesh eventuale, ndermjet ortakeve dhe te treteve mosmarrveshja do te zgjidhet ne gjykatën e rrethit Tirane. Vendimet e kesaj gjykate ndjekin rrugen ligjore te ankimit.

Marrdhenjet e punes ne shoqeri do te rregullohen me kontraten e punes ceshtjet qe nuk do te zgjidhen me kontraten e punes do te rregullohen duke u bazuar ne legjislacionin e punes te Republikes se Shqiperise.

Ky akt u nenshkrua rregullisht nga ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k.

O R T A K E T

/NEXHAT SHEQI/

/ VEBI KRAJA/

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
SHKODER



Nr.Rep. 999

Nr.Kol. 483

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Ne Shkoder sot me dt.26.04.1995, ne zyren e noterise Shkoder dhe per meje noteres Lumturi S.Hoxha, u paraqiten personalisht qytetqret Nexhat Sheqi dhe Vebi Kraja, lindur dhe banues ne Shkoder te identifikuar me aftësi per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te leternjoftimit te tyre personale dhe pasi u binda per aftesite e tyre i veretova ne shkrimet e deklarimeve te mesiperme.

NOTERE



LUMTURI S. HOXHA /

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DRINI" SH.P.K.

EMERTIMI? OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA

KREU I PARE

NENI 1

EMERTIMI

Duke u bazuar ne ligjen Nr.7512 dt.10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private te pavarura dhe privatizimin" ligjes Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjes 7667 dt.28.01.1993 "Per rregjistrin tregtare" me vullnetin e tyre te lire te shprehur me nenshkrimin e akteve themeluese, ortaket:

z.Nexhat Brahim Sheqi i dt.1958 banues ne lagj S.Halili, Rr.O.Kuka, Nr.99 Shkoder, dhe z.Vebi Shuajip Kraja i dt.1954 banues ne lagj.D.Matlija, Rr.Kopli kaj Shkoder:

Kane krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emerin "DRINI" sh.p.k.

NENI 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. e fiton personalitetin e saj juridik, me rregjistrimin ne gjykatën e rrethit Tirane, eshte person juridik privat shqiptar dhe veprimtarine e vet e zhvillon ne perputhje me kerkesat e ligjislacionit te Republikës se Shqiperise.

KREU I DYTE

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. eshte:

Prodhimi i materialeve inerte, prodhimi i materialeve te ndertimit, imp-exp. i artikujve industriale, ushqimore, materiale ndertimi, karburante, lubrifikante, vaj-guri, makineri e paisje, plehra kimike, produkte bujqesore e blegtorale, paisje elektroshtepiake me shumice e pakice etj.

Te gjitha keto veprimtari kane per qellim qe te arrihen objektivat e kesaj shoqerie.



KREU I TRETE

SELIA E SHOQERISE

NENI 4

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. eshte ne lagj. Bahcallek ne Shkoder. Ajo ushtron veprimtarine e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Munde te krijoj dege filiale, zyra perfaqesimi, apo qendra te tjera dytesore, ne perputhje me kerkesat dhe kriteret e caktuara nga organet perkatese dhe me ligjen e vendi t ku ato do te krijohen.

KOHEZGJATJA

NENI 5

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. eshte mbi 11 vlet. Por ajo munde te shperndahet edhe perpara ketij afati ne raste se vertetohen rrethana qe e bejne te pamundur vazhdimin e ketij aktiviteti, si dhe kur shperndarja e saj urdherohet ne menyre te prere ng ligja.

KAPITALI THEMELTARE DHE KUOTAT

NENI 6

Kapitali themeltare i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. eshte 600.000 lek, pjese e pandare e ortakeve Nexhat Sheqi dhe Vel Kraja, te cilet kane te drejten e administrimit te ketij kapitali.

NENI 7

Kuotat ose pjeset jane nominative dhe lehtesisht te transferueshme nga ortaket tek te tretet. Transferimi i tyre behet vetem me akt noteria

NENI 8

Kuotat ose pjeset jane te gjitha te emertueshme dhe te pandashme. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

KREU I KATERT

ORGANET E SHOQERISE

NENI 9

Organi me i larte i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte asambleja e ortakeve, qe ne rastin e kesaj shoqerije do te perfaqesohet nga ortaket Nexhat Sheqi dhe Vebi Kraja me president Nexhat Sheqin, vendimet e tija te marra ne perputhje me ligjen dhe aktet themeluese jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 10

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimore i shoqerise qe ne rastin e kesaj shoqerije perfaqesohet nga presidenti i saj. Ai ka te drejte te emerjoj dhe te shkarkoj likuidatoret, ekspertet kontabel, te miratoj raportet e kontrollit dhe te administrimit, te miratoje llogarite vjetore dhe fitimin, te zgjedhte kohen e veprimtarise se shoqerise apo dhe te urdheroj shperndarjen e saj.

NENI 11

Shoqerija me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. drejtohet nga presidenti! Ai ka te drejte te kryej te gjitha aktet qe i konsideron te mirreqena per shoqerine, te shese dhe te kembeje pasuri, te hyje ne marrdhenje me shoqeri te tjera qe jane krijuar dhe do te krijohen brenda dhe jashte Shqiperise, me qellim qe te sigurohet pjesmarrje per shoqerine.

NENI 12

Administratori i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. ka per detyre te mbaj dokumentacionin e rregullt te shoqerise dhe te informoje asamblene e ortakeve per te gjitha veprimtarine ekonomike te shoqerise.

NENI 13

Shoqerija me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k. vepron me rregjistrimin e prones private. Ajo pergjigjet per detyrimet e saja kontraktore dhe jashte kontraktore me pasurine e saj. Ortaket mbartin rrezikun qe rrjedh prej veprimtarise se shoqerise.

NENI 14

Ne raste se del e nevojeshme ose urdherihet nga ligja, kontrollin e shoqerise do ta kryej nje ekspert kontabel i emeruar nga ortaket. Ne raste se ne punen e tij do te verehen gabime ose behet i pamundur vazhdimi i punes prej tij ai shkarkohet.

NENI 15

Te punesuarit ne shoqeri kane detyrimin qe te ruajne karakterin sekret te punes se shoqerise, detyrim te cilin ata e ruajne edhe pas largimit te tyre nga shoqerija.

KREU I PESTE

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 16

Shperndarja e shoqerise minde te vije ne cdo kohe dhe per cdo lloj arsye, si per humbje te kapitalit, kur vertetohen rrethana qe e bejne te pamundur vazhdimin e kesaj veprimtarie si dhe kur shperndarja e saj urdherohet ne menyre te ~~per~~ prere nga ligja. Ne keto raste caktohet nje likujdator te cilin i jepen dhe detyra. Ai ben kujdes ne rradhe te pare, te shlyej detyrimet e shoqerise ndaj te treteve.

NENI 17

Persa nuk shprehet ne kete statut do te referohet ne shtesat ose ndryshimet e mundeshme te bera nga ortaket ne statut.

NENI 18

Ne raste mosmarrveshjes eventuale ne mes ortakeve dhe te treteve ato do te zgjidhen duke ju drejtuar gjykates se rrethit Tirane. Vendimit e kesaj gjykate ankohen ne baze te kerkesave ligjore.

NENI 19

Marrdhenjet e punes ne shoqeri do te rregullohen me kontraten e punes. Per ceshtje qe nuk rregullohen me kontraten e punes do te zbatohet legjislacioni i punes ne Republiken e Shqiperise.

NENI 20

Ky statut u nenshkrua rregullisht nga ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k.

ORTAKET E SHOQERISE

/ NEXHAT SHEQI /

/ VEBI KRAJA /

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE

SHKODER

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

№.Rep. 998

Nr.Kol 482

Ne Shkoder sot me dt.26.04.1995, para meje noteres Lunturi S.Hoxha u paraqiten personalisht Nexhat Sheqi dhe Vebi Kraja, per identitetin e te cileve u sigurova me leternjoftimet e tyre personale dhe pasi u binda se kane aftesite e kerkuara nga ligja i vertetova nenshkrimeve e deklarimeve



SINTESE E STATUTIT TE SHPK DRINI

Sipas vendimit te marre nga assembleja e ortakeve objekti i shpk DRINI Shkoder eshte zgjeruar. Si rezultat i kesaj lind e nevojeshme te behet pasqyrimi i ketyre ndryshime ne kete statut.

NENIT 3 i SHTOHET NENI 3/A

1. Ndertimin e objekteve te ndryshme ndertimi si objekte kulti, social kulturore, ushtarake, turistike, ndertesa banimi etj.
2. Ndertim dhe riparim urash, rruges, sisteme ujitjeje dhe bonifikuese.

O R T A K E T

NEXHAT SHEQI

VEBI KRAJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE SHKODER

NR. REPERTORI 520.....
NR. KOLEKSIONI 304.....

AUTENTIFIKIM NENESHKRIMI

Sot me daten 5 shkurt 1998 ne Zyren e Noterise Shkoder dhe para meje noteres Violeta Voin Sulkajt u paraqiten personalisht Nexhat Sheqi dhe Vebi Kraja qe te dy te identifikuar, me zotesi te plote per te vepruar te cileve iu vertetova permbajtjen e aktit dhe neneshkrimet e tyre.

NOTE RE
VIOLETA VOIN SULKAJ



10539/3
6319

KERKESE

KERKUESI

Vehbi Kraja administrator i shoerise
tregetare " DRINI - A " shpk banues ne
Shkoder.

OBJEKTI

Depozitimin prane rregjistrin tregetar te
Gjykates se rrethit Tirane te vendimit te
ortakut te vetem te shoerise tregetare
" DRINI " shpk

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

Une kerkuesi Vehbi Kraja jam ortak i vetem i
shoerise tregetare " DRINI " shpk dhe administrator
Shuajip Rrjollli.

Me vendim te ortakut te vetem te kesaj shoerie
eshte vendosur ndrimi i emertimit te shoerise nga
" DRINI " shpk ne " DRINI - A " shpk si dhe shkarkimi i
administratorit te z; Shuajip Rrjollli dhe emerimi i
administratorit z; Vehbi Kraja.

Kerkajme depozitimin e ketij vendimi prane
rregjistrin tregetar te Gjykates se rrethit Tirane.

KERKUESI

VEHBI KRAJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA E TIRANES

Nr. 1199 Rep

VERTETIM

Vertetohet se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi per
depozitimin e vendimit te ortakut te vetem u nenshkrua ne
prezencen timenga kerkuesi Vehbi Kraja per indetitetin e t
cilit u sigurova nga leter njoftimi perkates dhe une note
e vertetoj sipas ligjit:

Tirane ,me 17/3/199

Leter njoftimi
Nr. NF 086522

NOTERE

Handwritten signature



KERKESË

10539/3
6311

Kerkues: NEXHAT SHEQI lindur e banues ne qytetin e Shkodres.
VEHBI KRAJA lindur e banues ne qytetin e Shkodres

Objekti: Depozitimi i vendimit te asamblese se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI" sh.p.k.

Baza ligjore: Neni 7667 dt.28.01.1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne Rregjistrin Tregtare

Perpara: Gjykates se rrethit Tirane.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "DRINI"shp.k. eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr. 10539 dt.27.04.1995 dhe nr 10539 /2 dt.10.02.1998 e ka si ortak z.NEXHAT SHEQI dhe z.VEHBI KRAJA.

Me vendimin nr 2 dt.23.02.1999 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise eshte vendosur per te hequr si ortak z.Nexhat Sheqi ,duke u vendosur qe kjo shoqeri te mbetet nga dy ortake ne nje ortak dhe ortak e administrator te jete vetem z.VEHBI KRAJA i cili ne baze te kontrates se shit-blerjes se kuotave i ka blere kuotat e z.Nexhat Sheqi respektivisht ne masen 50% te kuotave te shoqerise,duke u bere keshtu pronare ekskluziv mbi krejt kapitalin fillestar te shoqerise ne vleren 600.000 lek .

Meqenese kerkesa i ploteson te gjitha kushtet e ligjes nr.7667 dt.28.01.1993 kerkoj te bej depozitimin e vendimit nr.2 dt.23.02.1999 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "DRINI "sh.p.k shkodre ne Gjykatën e rrethit Tirane

KERKUESIT

NEXHAT SHEQI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE SHKODER

Handwritten notes:
Kontrate shp.k. nr. 1801/93 dt. 1.11.1993
Vendime nr. 1801/92 dt. 23.2.1999
nr. 1801/92 dt. 2.11.1998
nr. 1801/92 dt. 10.2.1998
rep. kol.
nr. 1801/92 dt. 23.2.1999
nr. 1801/92 dt. 10.2.1998
nr. 1801/92 dt. 2.11.1998

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me dt.24.02.1999 ne zyren e noterise Shkodre para meje noteris Lunturi Hoxha u paraqiten personalisht kerkuesit z.NEXHAT SHEQI dhe z.VEHBI KRAJA per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te leternjoftimeve te tyre personale dhe pasi konstatova se i kane te gjitha aftesite e kerkuara nga ligja i vertetova nenshkrimet e deklarimet e mesiperme.

NOTERE

LUMTURI S.HOXHA



dup 4769

10539

dt 10/02/1998

GJYKATES RRETHIT

TIRANE

27/4/95

KERKUESA : 1. NESHAT SHEQI, i biri i Brahimit, banues ne Shkoder
lgj. S. Halili
2. Vehbi Kraja, i biri i Shuaqpit , banues ne Shkoder
lgj. Daniel Matlia.

ME OBJEKT : Depozitimin e vendimit te Asamblese se ortakëve
te SHPK Drini. Ligja 7667 dt. 28.1.1993

*Be de depozitimit
me vendimin
nr. 10539
dt. 27.4.95*

Me vendimin nr. 10539 dt. 27.4.1995 te Gjykes Rrethit
Tirane SHPK DRINI Shkoder ka si objekt te veprimtarise se saj
prodhim material sherte, prodhim materiale ndertimi, imp. exp,
i artkujes industriale ushqimor, materiale ndertimi, karburante dhe
lubrifikant, vajcari, makineri e paisje, plehra kimike, produkte
bujqesore e blektorale, paisje elektrotepiake me shumice dhe
pakice. Me vendimin nr. 2.2.1998 te asamblese se ortakëve eshte
vendosur zgjerimi i aktivitetit te shogerise sone dhe konkretisht
1. Ndertim objektesh te ndryshme ndertimi si objekte kulti, social
dhe riparim urash, rruges, sisteme ujitjeje dhe bonifikuese.
(nover V. Sulkajt)

Duke gene ceshtja sa sipri, kerkoi qe ngarnga ana e
juaj te me behet depozitimi i vendimit te me siperm te asamblese
se ortakëve duke u bere shenimet perkatese ne rregjistrin tregtar.

K E R K U E S I

NESHAT SHEQI VEBI KRAJA
[Signature] *[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE SHKODER

NR. REPERTORI 530
NR. KOLEKSIONI 306

AUTENTIFIKIM NENESHKRIMI

Sot me daten 5 shkurt 1998 , ne Zyren e Noterise
Shkoder dhe para meje notares Violeta Voin Sulkajt u paraqiten
personalisht Nexhat Sheqi dhe Vebi Kraja, qe te dy te identifikuar
me zotesi te plote per te vepruar te cileve lu vepruar mbajtje
e kerkeses dhe neneshkrimet e tyre.



NR 4214 10539

Shkoder, me 31.5.1997

Z. Kryetar

K E R K E S E

REGJISTRUAR
DT: 03 06 97
CAKTUAR GJYQTARIT

PERPARA

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

70) depozitimi
date 4-6.1987

[Handwritten signature]

KERKUES : 1. NEXHAT SHEQI, i biri i Brahimit dhe i Hasijes, i dtl 1958

1) *Vendur 27-9-1987* lindur dhe banues ne Shkoder.....

2) *Vendur N.2*
date 31.5.1987 2. VEBI KRAJA, i biri i Sjuajpit dhe i Gjyljjes, i dtl 1954,
lindur dhe banues ne Shkoder.....

OBJEKTI : 1. Kerkohe depozitimi i vendimit nr.2 te "DRINI" SHPK.

2. Pasqyrimi ne rregjistrin tregtar prane asaj Gjykate
te shteses ne objektin e veprimtarise se shoqerise se
mesiperme.

BAZA LIGJORE : Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"
dhe ligji nr.7667 date 28.1.1993 "Per rregjistrin tre-
gtar....."

Z. KRYETAR !

Sic del ngavendimi nr.2 date 31.5.1997 te asamblese
se ortakeve te "DRINI" SHPK, kjo shoqeri paska vendosur ta shtoje
objektin e veprimtarise se saj si vigon:

SHFRYTEZIM PAJISJESH NEN PRESION DHE PRODHIM GAZRASH
NEN PRESION.

Duke qene ceshtje keshtu kerkojme qe vendimi i siper-
permendur te depozitohet prane jush dhe ndrshimi i kerkuar te pas-

Kolegji i avokateve

SHKODER



K E R K E S E

Shkoder me 26.04.1995.

*Co' meqenese
dt. 27-4-95
[Signature]*

Nexhat Sheqi i biri i Brahimit dhe i Hasijes i dt.1958 lindur dhe banues ne Shkoder, lagj.S.Halili,Rr.O.Kuka,Nr.99 Shkoder.

Vebi Kraja i biri i Shuajpit dhe Gjyljies i dt.1954 lindur dhe banues ne Shkoder lagj,D.Matlija,Rr.Koplikaj....

O B J E K T I

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, "DRINI" sh.p.k. Shkoder.

D R E J T U A R

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

DEGES SE TAT-TAK RRETHIT SHKODER

Duke u bazuar ne ligjin me Nr.7512 dt.10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones Private te nismes se lire,te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit",ligjen Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjen Nr.7667 dt.28.01.1992 "Per rregjist-Tregtare" kemi krijuar nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar,te emertuar "DRINI" sh.p.k.me seli ne Shkoder lagj.Bahcallek,me ortake Nexhat Sheqi dhe Vebi Kraja dhe amistratori Shuajp Rrjollli,me kapital fillestare mbi 600.000 lek te dredhur ne numer llogarie Nr. [] prane bankes kombetare tregtare dega Shkoder,me kohe zgjedhje 11 vjet dhe me objekt veprimtarie,prodhim materiale inerte,prodhim materiale ndertimi,exp-imp. i artakujve industrial,ushqimore,materiale ndertimi karburanee e lubrifikanteve,vaj-guri,makineri e paisje,plehra kimike,materiale bujqesore,blegtorale,paisje elektro shtepiake,veprimtari imp-exp.te ketre artikuljeve dhe cdo operacion qe bashkohet me veprimtarite e mesiperme dhe qe konsiderohet i pershtateshem dhe me leverdi per rretjen dhe zhvillimin e metejshem te aktivitetit te shoqerise.

Meqenese kemi kryer te gjitha veprimet qe parashikon ligja,ju drejtohem ju,qe pasi ta shqyrtoni kerkesen dhe dokumentat perkates,te rregjistroni kete shoqeri si person juridik.

K E R K U E S I T

/NEXHAT SHEQI/

/VEBI KRAJA /

KONTRATE SHITJE

Sot me dt. 01.031999 nentehjete e nente ditën e Henë ne zyren e noterise ,para meje Noteres Lumturi Hoxha u paraqiten personalisht palet kontraktuese:

SHITESI: Nexhat Sheqi i biri i Brahim dhe Hasije i dt.1958 lindur e banues Shkoder,lagj."S.Halili",Rr.O.Kuka",Nr.99.

BLERESI: Vehbi Kraja i biri i Shuajp dhe Gjylje i dt1954 lindur e banues ne Shkoder lagj. "D.Matlja" ,rr."Koplikej".

Per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te leternjoftimeve te tyre personale dhe pasi u binda se i kane te gjitha aftesite e kerkuara nga ligja me kerkese te tyre i redaktova kete kontrate shitje kapitalesh si me poshte pershkruhet:

Shitesi Nexhat Sheqi eshte pronar i nje kapitali prej **50%** ose **300.000** lek pronesi kjo qe rrjedh nga **Vendimi** i Gjykates se rrethit **Tirane** Nr.10539 dt.27.04.1995.me rastin e rregjistrimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "**DRINI**" sh.p.k. Shkoder.

Shitesi Nexhat Sheqi ka investuar me rastin e rregjistrimit si person Juridik nje kapital ne masen 50% ose 300.000 lek .Kete kapital ne masen 50% ose 300.000 lek ja shet ortakut te tij z.Vehbi Kraja.

Shitesi Nexhat Sheqi ka marre kapitalin e investuar me rastin e rregjistrimit si person Juridik,kapital ky ne vleren 300.000 lek nga bleresi Vehbi Kraja.

Nga ky moment shitesi shgkarkohet nga pronesia prej 50% ose 300.000 lek te investuar ne kete shoqeri dhe pronare ekskluziv behet bleresi Vehbi Kraja duke u bere keshtu pronare i gjithe sasise se investuar me rastin e rregjistrimit si person juridik i shprehur ne perqindje 100% ose 600.000. **Lek**

Palet e lexuan kontraten dhe pasi konstatuan se kane ashprehur vullnetin e lire te tyre e nenshkruan ate si me poshte.Une noterja vertetoj kontraten.

PALET KONTRAKTUESE

SHITESI
NEXHAT SHEQI

Nexhat Sheqi

BLERESI
VEHBI KRAJA

Vehbi Kraja

NOTERE
LUMTURI S. HOXHA

Lumturi S. Hoxha



Shoqeria private tregtare
"DRINI" sh.p.k.


V E N D I M
NR 2 DATE 23.02.1999

Sot me dt 23.02.1999 Ne mbledhjen e Asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DRINI"sh.p.k. me ortak z.Nexhat Sheqi dhe z.Vehbi Kraja,e njohur kjo shoqeri si person juridik me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane nr 10539dt.27.04.1995 dhe 10539/2 dt.10.02.1998,vendosem te bejme ndryshimin e nenit te aktit te themelimit dhe nenit te statutit te shoqerise per heqje te ortakut z.Nexhat Sheqi i cili ne baze te kontrates se shit-blerjes se kuotave i ka shitur kuotat z.Vehbi Kraja respektivisht ne masen 50% te kuotave te shoqerise duke u bere z.Vehbi Kraja pronare ne krejt kapitalin themeltare te kesaj shoqerie ne masen 100% e barabarte me vleren 600.000 lek.

Pra perfundimisht ,per keto ndryshime ne nenet e aktit te themelimit dhe statutit vendosem te njoftojme Gjykatën e rrethit Tirane ,per te bere ndryshimet perkatese ne rregjistrin tregtare prane kesaj gjykate.


ORTAKET

NEXHAT SHEQI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE SHKODER

VEHBI KRAJA



rep. 180
kol. 92

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sote me dt.01.03. 1999 ne zyren e noterise Shkoder para meje noteres Lumturi Hoxha u paraqiten personalisht ortaket e sipertreguar per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te leternjoftimeve te tyre personale e pasi u binda se i kane aftesite qe u kerkon ligja i vertetova nenshkrimet e mesiperme.



NOTERE
LUMTURI S. HOXHA



MINISTRIA E NDERTIMIT DHE TURIZMIT

N.1999

KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE

L I C E N S E

Shoqeria private me emertimin " DRINI"
Me adrese ne Shkoder
Me drejtues teknik z. Bukurije Spahija.
Me drejtues ligjor z. Nexhat Sheqi, Vehbi Krasa
Eshte regjistruar ne regjistrin themeltar te
ndermarrjeve per zbatim, nga data 23.10.1995
per kategorite e specifikuara te punimeve:

Per zbatim:

Kat1- punime dheu, sistemime e taracime terenesh, etj.

Kat2/a - prodhim materiale inerte, rere, cakell, gure, mermer, etj.

c - prodhim elementesh te parafabrikuar, betoni e b/armer.

d - prodhim elemente te paranderura e armocementi

Kat3/a - ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

b - ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat8/b - ndertim ujesjellesa e kanalizime.

g - punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulik

Kat10/a - rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj.

Sekretare e Komisionit

Sllavena Safa

Pulla e Takses 2183

data 08.11.1995

Kryetar i Komisionit

Andrea Mazniku

Shenim ; Kjo license eshte e vlefshme deri ne daten 23.10.2000.

VERITETI DËRBYSHKËT ORIGINALIN

NO. 1000
ELVIRA GANI ALIJE

MINISTRIA E NDERTIMIT DHE TURIZMIT Z.0690
KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE

L I C E N S E

Z. Bukurije Qamli Spahija, lindur me 23.12.1950 ne Shkoder, me profesion inxhinier h/teknik diplomuar ne vitin 1973, ne Fakultetin e inxhinierise se Ndertimit, dega hidroteknike, banues ne Shkoder, lagja "Ahmet Haxhija", rruga "Musa Luli", nr.18.

Ne baze te kerkeses dhe te dhenave disponuese i jepet license per zbatim dhe rregjistrohet ne regjistrin themeltar te zbatimit qe nga data 23.10.1995, per kategorite e specifikuara te punimeve:

Kat1 - punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj.

Kat2/a - prodhim materiale inerte, rere, gace, gure, mermer, etj.

Kat2/c - prodhim elemente te parafabrikuara betoni e b/arme.

Kat2/d - prodhim elemente te paranderura e armocementi.

Kat3/a - ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat3/b - ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj. mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat3/b - ndertim ujesjellesa e kanalizime.

Kat3/g - punime mbrojtjeje dhe sistemimi hidraulik

Kat10/a - rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj.

Sekretare e Komisionit

Silavena Safa

Kryetar i Komisionit

Andrea Mazniku

Pulla e Takses 2182

data 08.11.1995

Shenim: Kjo license eshte e vlefshme deri ne daten 28.08.2000.

KONTRATE PUNE

Sot me 09.02.1998 ne zypren e noterise Shkoder para meje noterese
u paraqit personalisht palet kontraktuese si me poshte:

PUNEDHENESI : Nexhat Sheqi dhe Vehbi Kraja presidente te firme
DRINI Sh.P.K. Shkoder.

PUNEMARRESI : Bukurije Kraja (Spahija) e bija e Familit e dtl.
1950 banuese ne Shkoder. Per identitetin e te cile-

-ve u sigurova dhe pasi konstatova se i kane te gjitha aftesate
e kerkuara nga ligja i redaktova kete kontrate pune si me poshte
rrezulton.

Punedhenesit e mesiperem deklaroi se marrin ne pune pune-
-marresen e mesiperme ne pune si drejtuese teknike te firmes se tyre
me nje page mujore prej 7000 lek, page te cilen do e marre me dt.15
te cdo muajit.

Kohezgjatja e kesaj kontrate eshte per nje afat te pac aktu-

E punesuara ka per detyre te ndjeke te gjitha punimet ndert-
imore te kesaj firme.

Kjo kontrate, pune pasi u lexua me ze te larte dhe pasi u gj-
konforme deshires dhe te kerkeses se paleve u pranua dhe u nenshkru-
prej tyre si me poshte rrezulton.

PALET KONTRAKTUESE

PUNEDHENESIT

NEXHAT SHEQI

VEHBI KRAJA

PUNEMARRESI

BUKURIJE SPAHIJA (KRAJA)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHPK " DRINI "
S H K O D E R

V E N D I M Nr. 1

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SH.P.K. "DRINI " SHKODER

Sot me daten 2 shkurt 1998 asambleja e ortakeve e SHPK Drinit Shkoder e perbere nga ortaket e kesaj shoqerije zoterinjte Nexhat Sheqi dhe Vehbi Kraja gjate shqyrtimit te aktivitetit te kesaj shoqerije konstatuan se :

Qe nga themelimi i kesaj shoqerije aktiviteti i saj ka qene me rentabilitet duke i siguruar shoqerise shtimin e kapitalitetit te saj themeltar ne mase te konsiderueshme. Duke patar rrezultate te mira, kjo shoqeri ndjen te domosdoeshme zgjerimin e aktivitetit te saj, duke u marre vec atyre aktiviteteteve qe jane te percaktuara qarte ne statutin e kesaj shoqerije dhe me ndertimin e objekteve te ndryshme te ndertimit si objektet e kultit, social kulturore, ushtarake, turistike dhe ndettesa banimi. 2. Nderzim dhe riparim urash, rrugesh, sisteme ujitjeje dhe bonifikuese.

Per zgjerimin e aktivitetit ner keto sektore dy ortake ne mbledhjen e asamblese se shoqerise se jane plotesisht dakort me shtesen e me sipërme te aktivitetit te SHPK DRINI.

PER KETO ARESYE

Asambleja e ortakeve vendosi te shtoj aktivitetin e SHPK Drini dhe ne keto drejtime 1. Ndertim te objekteve te ndryshme ndertimi si objekte kulti, social kulturore, ushtarake, turistike, ndettesa banimi etj.

2. Ndertim e riparim urash, rrugesh, sisteme ujitjesh dhe bonifikuese.

O R T A K E T

NEXHAT SHEQI

VEHBI KRAJA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE SHKODER

530
NR! REPERTORI !!!
NR.KOLEKSIONI 304.....

AUTENTIFIKIM NENESHKRIMI

Sot me daten 5 shkurt 1998 ne Zyren e Noterise Shkoder dhe para meje noteres Violeta Voin Sulkajt u paraqiten personalisht ortaket Nexhat Sheqi dhe Vehbi Kraja, qe te dy te identifikuar, me zotesi te plote per te vepruar, te cileve iu vertetova permbajtjen



aktit dhe neneshkrimet e tyre.

N O T E R E
VIOLETA VOIN SULKAJ



SHOQERIJA TREGTARE "DRINI" SHPK

SHKODER

V E N D I M N R.2 I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot ne Shkoder me 31.5.1997 shoqerija tregtare "DRINI" SHPK me dy ortake NEXHAT SHEQI dhe VEBI KRAJA, e njohur si person juridik me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.10539 date 27.4.1995 vendosi:

Te beje shtese ne objektin e veprimtarise se saj dhe pikerisht te ndryshoje ne nenin 2 te aktit te themelimit dhe nenin 3 te statutit si vijon:

Objekti i veprimtarise do te shbohet me

SHFRYTEZIM PAJISJESH NENPRESION DHE PRODHIM GAZRASH NEN PRESION.

Per kete shtese ne objekt te veprimtarise ortakët do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Tirane me nje kerkese per t'u miratuar shtesa e sipercituar dhe per t'u pasqyruar ne rregjistrin tregtar prane asaj Gjykate.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ORTAKET E "DRINI" SHPK

NEXHAT SHEQI



VEBI KRAJA



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. 10539/1

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me daten 4.6.1997 une gjyqtare *Gjyfti 30/97*
ne Gjykaten e Rrethit Tirane, pasi pashe kerkesen e ortakëve te "DRINI"
SHPK: NEXHAT SHEQI dhe VEBI KRAJA, te cilet kerkojne per te depozituar
ne rregjistrin tregtar te kesaj Gjykate, vendimin nr.2 date 31.5.1997
asamblese se ortakëve te shoqerise se tyre:

K O N S T A T O V A

Kerkuesit jane ortakë te shoqerise me pergjegjesi
te kufizuar "DRINI" SHPK, e njohur kjo shoqeri si person juridik me
vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.10539 date 27.4.1995.

Me vendimin nr.2 date 31.5.1997 asambleja e orta-
këve te kesaj shoqerije ka vendosur te shtoje objektin e vepristari-
se se saj ne: SAFRYTEZIM PAJISJESH NEN PRESION DHE PRODHIM GAZRASH
NEN PRESION.

Kjo asamble ortakësh kerkon te beje depozitim in e
ketij vendimi ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane,
kerkese, e cila eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet:

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per rregji-
strin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tre-
gtare"